



Le të kontribuojmë për fuqizimin e komunitetit të AFP-së!

# INNOVET ALBANIA BULETIN

Publikimi 4, Mars 2021

Inspiring young girls and women to dream, believe and dare!

albanianskills



**Fatmira Prodani**

## Të dashur lexues,

Jam e nderuar t'ju prezantoj me publikimin e katërt të **Buletinit INNOVET ALBANIA!** Emri im është Fatmira Prodani dhe jam lektore në degët IT & Multimedia në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu". Rrugëtimi im i mësimdhënies nisi në një shkollë të arsimit profesional, ku u njoha me Anën, me të cilën kam bashkëpunuar për një kohë të gjatë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit profesional në Shqipëri. Kur Ana më ftoi për t'u bashkuar me AlbanianSkills u ndjeva e privilegjuar të isha pjesë e kësaj nisme mahnitëse që promovon aftësitë profesionale të të rinjve. Kisha qenë e lidhur ngushtësisht me Arsimin dhe Formimin Profesional dhe e dija se sa i rëndësishëm ishte ai për tregun e punës. Ka ende shumë prindër, por edhe të rinj që hezitojnë të zgjedhin arsimin profesional. Nga përvoja ime personale, unë jam plotësisht e bindur se sistemi i AFP-së është një aset që duhet të përqafohet nga të gjithë ata të rinj që kanë pasione dhe aftësi në fusha të ndryshme profesionale.

Unë e shoh dhe e prek nga afër ndryshimin mes studentëve në profilim e Teknologjisë së Informacionit dhe Multimedias. Ata që vijnë nga shkollat e arsimit profesional ose ata që kanë ndjekur trajnime profesionale janë shumë herë më të gatshëm dhe të përgatitur për tregun e punës, në krahasim me kolegët e tjerë. Në shumicën e vendeve evropiane, veçanërisht në vendet gjermano-folëse, sistemi VET prodhon punonjës të rinj shumë të aftë, të gatshëm për tregun e punës dhe bizneset, duke shërbyer si një nxitës tejet i rëndësishëm edhe në aspektin ekonomik. Ne duhet të përpiqemi të ruajmë profesionet tradicionale dhe njëherazi të zhvillojmë profesione të reja që ndërtojnë talentet dhe interesat e të rinjve. Ekzistojnë aftësi të tilla si ato të krijuesve grafikë, krijuesve të faqeve në internet, krijuesve të uebit dhe edituesve të videove që ofrojnë një gamë të gjerë profesionale dhe mundësi punësimi për të rinjtë dhe për njerëzit me një larmishmëri talentesh dhe aftësish. Gjatë këtyre 6 viteve si anëtare e jurisë së dizajnit grafik në Konkursin kombëtar që Albanian Skills organizon, kam dëshmuar interesin dhe vullnetin e biznesit për të punësuar dhe trajnuar të rinj të talentuar. Profesionistët krijuar të cilët janë në avantazh me mjetet, teknologjitë dhe trendet më të fundit të industrisë janë gjithnjë e më shumë në kërkesë të lartë dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të mësuarit të shndërrohet në një prioritet të vazhdueshëm!

## Fatmira Prodani

Anëtare e Bordit Ekzekutiv të Albanian Skills - NASC dhe anëtare e jurisë në kategorinë e Dizajnit Grafik

## Rubrikat e Innovet Albania - Publikimi i Katërt

Ky publikim u përgatit dhe u editua nga: Fatma Memalli

### Kur pasioni shndërrohet në profesion!

Njihuni me historitë e Xhesika Lleshit dhe Elsa Pashollarit, dy fitueset vajza të edicionit të 6-të Konkursit Kombëtar të Aftësive Shqiptare.

### Indeksi Global i Inovacionit 2020

Që prej vitit 2007, Indeksi Global i Inovacionit (IGI) rendit në mënyrë vjetore më shumë 130 vende të botës.

Coffee Talk 7, një takim ndryshe dedikuar vajzave dhe grave në AFP!

### "Njeriu është kapiten i fatit të tij" Intervistë me Arjodita Mustalin

Themeluese e VIGAN Group dhe e disa kompanive të suksesshme në Shqipëri me impakt kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe Drejtore të Përgjithshme të ABSA

### Qendra e parë e Ekselencës Profesionale në Shqipëri

Intervistë me znj. Flutura Vaqarri, Drejtore të qendrës nga viti 2005 në Shkollën Profesionale "Hoteleri-Turizëm" në Tiranë.

Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i studentëve të AFP

### Projekti INTERVET WB

INTERVET WB është një mundësi e shkëlqyer për të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional në Ballkanin Perëndimor...

### Të njohim partnerët tanë të INTERVET WB

Në këtë rubrikë të buletinit të sotëm do të udhëtojmë drejt Kosovës dhe do të njihemi nga afër me Prishtina Rea-n.

Le të festojmë me Albanian Skills Ditën Ndërkombëtare të vajzave në TIK!



## KUR PASIONI SHNDËRROHET NË PROFESION!

### Njihuni me historitë e fitueseve vajza të edicionit të 6-të Konkursit Kombëtar të Aftësive



**Elsa Pashollari**

#### Përshëndetje të gjithë lexuesve të buletinit INNOVET Albania!

Quhem Elsa Pashollari, jam 19 vjeç dhe jetoj në qytetin e Korçës. Aktualisht po vijoj kursin e parukerisë dhe jam drejt përfundimit të tij. Përvoja ime me AlbanianSkills ka qenë një përvojë e bukur dhe e suksesshme në të njëjtën kohë. Një përvojë që i tejkalon kufijtë dhe do të më japë mundësinë të angazhohem në një event të përmasave europiane siç është EuroSkills. Këtë angazhim po e pres me padurim, pasi e shoh si një përvojë me shumë vlerë për profesionim tim. Të qenit një vajzë e suksesshme në profesionin që kam zgjedhur është një ëndërr që gjithnjë kam patur dhe tashmë po e vazhdoj. Pasionin në këtë fushë e kam zbuluar kur kam qenë 14 vjeç, duke bërë gjëra të vogla që për mua kishin një domethënie të madhe.

E dashuroja punën me flokët dhe shpeshherë eksploroja modele dhe metoda të ndryshme stilimi. Isha një vajzë që kërkoja të ecja përpara dhe kisha dëshirë të zbuloja gjëra të reja. Dhe vjen një ditë që më jepet mundësia që ëndrrën time ta ktheja në realitet. Vendosa të nis një kurs parukerie dhe pas 1 muaji pata mundësinë të marr pjesë në Konkursin e Aftësive që AlbanianSkills organizon. Mora pjesë dhe i thashë vetes se do të jap maksimumin tim për të fituar. E arrita qëllimin tim, fitova vendin e parë dhe u gëzova jashtëmase. Pas kësaj eksperience rrugëtimi im profesional ka qenë në ngjitje.

Kam hasur edhe pengesa në këtë rrugëtim sepse nuk është e lehtë të marrësh profesionin e jetës tënde. I kam tejkaluar duke i dhënë vetes detyrë të mos ndaloj kurrë përballë tyre. Po e ilustruj këtë me një shembull shumë të thjeshtë. Në fillim e kam pasur shumë të vështirë ta realizoja siç duhej gërshetin dhe praktikohesha çdo ditë për ta arritur. Vetëm falë punës së vazhdueshme, me kalimin e kohës ja dola. Sot i them vetes se kurrë nuk do të dorëzohem derisa të bëhem një parukiere profesioniste dhe të mësoj vajzat e reja atë çka unë nisa dhe arrita të jem sot. Ky është edhe mesazhi im për gjithë të rinjtë: **Vazhdoni ëndrrën që keni dhe kurrë mos u dorëzoni.** Ecni përpara dhe vetëm ecni, pavarësisht pengesave që do të hasni në rrugën tuaj. **Është një rrugë e gjatë që ka pafund kthesa, por në fund gjendet një drirë ku ndriçon ëndrra juaj!**



Quhem Xhesika Lleshi dhe jam 18 vjeç, aktualisht studioj për Komunikim dhe Dizajn Grafik në Universitetin Evropian të Tiranës dhe njëkohësisht punoj si fotografe e pavarur. Pasioni im për fotografimin ka nisur fillimisht nga motra ime e madhe dhe më pas është rritur gradualisht gjatë gjithë vitit të parë të shkollës së mesme, kur krijova klubin e parë të fotografisë në shkollë, ku mbledheshim të gjithë së bashku për të mësuar gjëra të reja në lidhje me fotografimin. Përgjatë pjesëmarrjes time të parë në edicionin e 5-të të Konkursit Kombëtar të Aftësive, megjithëse ishte hera ime e parë që përdorja një aparat fotografik profesional, arrita të realizoja fotografi të mahnitshme dhe të fitoja çmimin e parë. Kjo ngjarje ka qenë një motivuese shumë e fortë për ta shndërruar fotografimin në diçka më shumë sesa thjesht një hobi dhe tashmë janë mbushur 2 vite



**Xhesika Lleshi**

që e praktikoj fotografimin si profesion. Pjesëmarrja sërish në edicionin e 6-të të konkurseve më ndihmoi të kuptoja se sa shumë ishte përmirësuar puna ime. Komuniteti i fotografëve po rritet çdo ditë dhe është një komunitet ku anëtarët janë shumë mbështetës dhe ndihmues ndaj njëri-tjetrit. Kam hasur disa vështirësi përgjatë rrugëtimit tim, por gjithmonë kam arritur t'i shndërroj ato në diçka nga e cila mund të përfitoja për t'u përmirësuar më tej. Kjo është gjithashtu ajo që do t'u thoja të gjithë të rinjve. Asnjëherë mos u dorëzoni nga ajo që dëshironi të arrini. **Suksesi nuk është kurrë i menjëhershëm. Nëse suksesi do të ishte i lehtë, atëherë të gjithë do të ishin në gjendje të bënin gjithçka.**







## **“Njeriu është kapiten i fatit të tij”**

**Intervistë me Arjodita Mustali-n**

**VIGAN**  
State of giants.

### **Arjodita Mustali**

**Themeluese e VIGAN Group dhe e disa kompanive të suksesshme në Shqipëri me impakt kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe Drejtoreshë e Përgjithshme e ABSA**

**1. Tashmë ju keni arritur të konsolidoni një karrierë të suksesshme disavjeçare në fushën e biznesit dhe sipërmarrjes. Cilin do të veçonit si momentin më sfidues të këtij rrugëtimit dhe si arritët ta tejkaloni atë?**

Rrugëtimi i sipërmarrësit mund të lindë në mënyrë shumë spontane, të paplanifikuar. Madje kështu është më mirë. Gjithsesi, ky mund të quhet rrugëtim vetëm nëqoftëse e shndërron në mision. Si sipërmarrës, je përherë mes klientit dhe stafit, je pala e besuar e të dyve dhe duhet përherë të ruash komunikim, etikën profesionale dhe ndjesinë e përfitimit e shpërblimit mes të dyve. Për një sipërmarrës çdo ditë është sfidë. Sfidë për të mbetur një njeri me vlera me çdo njeri por më shumë me vetveten. Për shembull, sfida ime ka qenë të ruaja e transmetoja vlerat që besoj tek punonjësit, në një periudhë kur nuk kisha asgjë për t'i dhënë. Çfarë bëra? Zgjodha t'i ofroj një ëndërr, një mision, një objektiv, dhe ata vazhduan vrapin bashkë me mua. Jo vetëm në ditët e mia të para, por sot e përditë ka sfidë.

**2. Si është të jesh një vajze e re apogrua sipërmarrëse në Shqipëri? Si kanë qenë fillimet e tua, a ke hasur pengesa që lidhen me statusin tënd gjinor dhe si po evoluon bota e biznesit në këtë drejtim?**

Dallimet gjinore ekzistojnë. Sipërmarrja nuk është përjashtim. E sigurt është që për arsye që nuk kanë të bëjnë me zotësinë tënde, ti kupton se nuk je aq larg sa je përpjekur. Si sipërmarrëse e re, aq sa e pret këtë gjë, aq edhe rrezikon të shkurajohesh. Është e vërtetë që ne nuk kemi në dorë mendësinë e secilit apo mendësinë kolektive, por na takon ta ballafaqojmë këtë situatë, jo ta shmangim. Falë grave e vajzave sipërmarrëse që nuk përthihen nga paragjykimi dhe objektifikimi, sot kemi një botë biznesi më të hapur e pranuese.

**3. Çfarë është inovacioni për ju? Bazuar në përvojën tuaj, cilat janë risitë që ka sjellë sektori BPO në Shqipëri?**

Inovacioni është e ardhmja. Për biznesin, për shoqërinë, për të rinjtë sidomos. Zemra e inovacionit janë startup-et. BPO (Shërbimet e nënkontraktuara) dhe e gjithë Industria e Shërbimeve Teknologjike janë një zgjidhje dhe lehtësim për çdo industri dhe një rrugë më e shpejtë drejt zhvillimit dhe rritjes së bizneseve në tërësi. Kjo rritje ka ardhur në formën më të arrirë, si simbiozë mes kompanive e stafeve. Nënkontraktimi i shërbimeve ka rritur bashkëpunimin dhe raportet mes kompanive duke forcuar ekonominë B2B. Gjithashtu, BPO nxit mbështetjen dhe rritjen e profesioneve të lira, të cilat e sjellin vendin tone disa hapa më pranë pikes ku ka vite që e projekton veten. Prej shumë vitesh, duke njohur vlerat e BPO (Shërbimet e Nënkontraktuara) kam lobuar që kjo industri të jetë e njohur dhe funksionale edhe në Shqipëri përmes formave të ndryshme në bashkëpunim me qeverinë dhe kompanitë. Besoj se më në fund ka ardhur koha t'i njihen vlerat kësaj industrie.

**4. Çfarë i mësoi pandemia biznesit dhe drejt cilash aftësi po orientohet e ardhmja?**

Pandemia e gjeti biznesin shqipar thuajse të papëratitur, jo nga ana e stafit, jo nga ana e procedurave apo strukturimit të biznesit, por nga ana e digjitalizimit. Pandemia zgjoi biznesin dhe e bëri të kuptojë se duhet të ndërtojë një plan risk uku komponenti kryesor është digjitalizimi, pasi operimi në kushte ekstreme për një biznes mund të rezultojë fatal nëse biznesi nuk ka përqafuar inovacionin dhe digjitalizimin. Mundt të them se po aq kompania duhet të përkujdeset për digjitalizimin e punonjësve (Digital Skills) pasi nevojitet një potencial i madh njerëzor nga ana cilësore për të drejtuar strukturat e digjitalizuara në biznes.





**5. Një nga projektet e tua më intriguese është libri "THE FEMALE LEADERS OF TOMORROW", në të cilin ju keni qenë bashkëautore. Si mund t'i nxisim vajzat dhe gratë të besojnë tek potenciali i tyre si lidere dhe të guxojnë?**

Është thelbësore që gratë dhe vajzat të kuptojnë veten dhe të edukohen që të shohin anën më të mire brenda vetes së tyre. Aty gjendet potenciali njerëzor. Ky potencial nxjerr në pah karakteristika lidere dhe ato vijnë me risqe. Një grua nuk është lidere vetëm në biznes, por edhe në familje, shoqëri e kudo ku ajo gjendet. Nëse e nxjerrim konceptin e lideres jashtë kornizave, atëherë çdo grua do ndjehet vetëvetja duke guxuar e duke drejtuar.

**6. Cili do të ishte mesazhi juaj për të gjithë lexuesit e buletinit, për të gjithë të rinjtë dhe të rejat në Shqipëri?**

Ndonjëherë të rinjtë e lidhin rininë me lirinë pa impenjime dhe kështu humbasin mundësi për t'u bërë ata që duan të jenë në të ardhmen. Liria e vërtetë ndjehet atëherë kur përqafohen impenjimet. Me këtë dua të them imoenjimet e mendjes. Nxiteni mendjen tuaj të jetë kureshare, të pyesë, të thojë PO ndaj mundësive e të lexojë. Kështu do të mund të bëni realitet shprehjen:

**"Njeriu është kapiten i fatit të tij"!**

## **Indeksi Global i Inovacionit për vitin 2020**

Që nga zbulimi i shkëndijave të para në periudhën e hershme prehistorike të epokës së gurit, tek përdorimi i kontrolluar i zjarrit përmes një sërë transformesh në larmishmërinë e formave që njohim sot, inovacioni na ka bashkëshoqëruar përgjatë gjithë ekzistencës tonë njerëzore, duke ndikuar katërcipërisht në mënyrën se si krijojmë, zhvillojmë dhe përditësojmë metodologji dhe praktika të reja për të përballuar sfidat e kohës. Vetëm pak muaj më parë, inovacioni - kryesisht në gjetjen e trajtimeve dhe vaksinave efikase si kundërpërgjigje ndaj kësaj pandemie, ishte pishtari i shpresës për të kapërcyer izolimin dhe krizën shumëplanëshe botërore. Inovacioni është pikërisht zemra e progresit. **Por, a e dini se ekziston një indeks që mat inovacionin në shkallë globale?**

### **Kush do ta financojë inovacionin?**

Që prej vitit 2007, **Indeksi Global i Inovacionit (IGI)** rendit në mënyrë vjetore më shumë **130 vende të botës** bazuar në suksesin dhe kapacitetin e tyre në fushën e inovacionit. Qëllimi i këtij indeksi është të sigurojë të dhëna të detajuara mbi inovacionin dhe të ndihmojë politikbërësit dhe ekonomitë në vlerësimin e performancës së tyre të inovacionit dhe ndërmarrjen e politikave ekonomike të mirëinformuara. Botimi i vitit 2020, i publikuar në një situatë të pazakontë trazirash ekonomike, shqyrton dhe adreson një pyetje tejet themelore: **Kush do ta financojë inovacionin?** Aftësia për t'u mbështetur dhe për të siguruar akses në burime të qëndrueshme financiare është një sfidë e vazhdueshme për inovatorët në të gjithë botën dhe po bëhet veçanërisht e vështirë si rezultat i pandemisë aktuale. Burimet e financimit luajnë një rol jetik në çdo fazë të ciklit të inovacionit që nga konceptualizimi i një produkti, shërbimi ose teknologjie deri te komercializimi i tij dhe më gjerësisht. Para pandemisë, krahaskemave publike të financimit, aktorë të rinj sovranë dhe organizatat jofitimprurëse, kishin filluar të shfaqeshin në skenën e financimit të inovacionit, ndërkohë që gjetjet e këtij raporti tregojnë se kjo krizë ka nisur ta ngadalsojë këtë zhvillim.

**Burimi:** <https://www.globalinnovationindex.org/>

### **Renditja Globale për vitin 2020**

IGI e vlerëson inovacionin duke u bazuar në tre tregues:

- **Treguesi i inputit të Inovacionit** synon të mas elementet e ekonomisë kombëtare që mundësojnë aktivitetet inovative.
- **Treguesi i outputit të inovacionit** ofron informacion rreth produktit dalës që vjen si rezultat i aktiviteteve inovative të ekonomive.
- **Treguesi i përgjithshëm** që përfaqëson mesataren e rezultateve të dy treguesve të mësipërm.

**Në renditjen botërore Shqipëria renditet në vendin e 83-të.**

|      | GII | Innovation inputs | Innovation outputs |
|------|-----|-------------------|--------------------|
| 2020 | 83  | 74                | 91                 |
| 2019 | 83  | 70                | 93                 |
| 2018 | 83  | 69                | 95                 |

  

|                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |                                                                                       |
|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| 1                                                                                     | 2                                                                                     | 3                                                                                     | 4                                                                                     | 5                                                                                     | 6                                                                                     | 7                                                                                     | 8                                                                                     | 9                                                                                     |
|  |  |  |  |  |  |  |  |  |
| 2020                                                                                  | CH                                                                                    | SE                                                                                    | U.S.                                                                                  | U.K.                                                                                  | NL                                                                                    | DK                                                                                    | FI                                                                                    | GER                                                                                   |



## **Flutura Vaqarri**

**Drejtoreshë e Shkollës  
Profesionale “Hoteleri-Turizëm”  
në Tiranë, që nga viti 2005.**

**Që nga viti 2005 ju drejtoni me sukses shkollën profesionale “Hoteleri-Turizëm” në Tiranë. Cilat janë sfidat që ju është dashur të kapërceni e të përballeni për të mbërritur deri këtu?**

Që nga shtatori 2005, drejtoj shkollën “Hoteleri-Turizëm” Tiranë, pas një përvoje 8 vjeçare si mësuese e lëndëve profesionale të kësaj shkolle. Sigurisht që nuk ka qenë e lehtë të kryeja këtë detyrë, pasi shkolla vetë si institucion, por edhe të rinjtë kanë sfidat e tyre. Në atë kohë që unë mora drejtimin e shkollës, godina e shkollës ishte e dëmtuar, përgjithësisht mungonin ambjentet e praktikave profesionale, mjete dhe pajisjet e punës në to, mungonin tekstet shkollore, mësuesit e lëndëve profesionale ishin në fazat fillestare të trajnimit etj. Në ato vite kishte një numër relativisht të kufizuar nxënësish që studionin në Drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm”, i cili më vonë u bë drejtimi më i kërkuar nga të rinjtë. Të gjitha këto ishin sfida të kohës për mua si drejtuese. Një shkollë shqiptare, po ofronte për herë të parë në Shqipëri, drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, falë një bashkëpunimi midis qeverisë shqiptare dhe asaj austriake.

**Sa ka ndryshuar situata në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri që nga viti 2005 e deri më sot? Cilat do të përmendnit si disa nga strategjitë dhe risitë më me ndikim në përfshirjen dhe promovimin e vajzave në AFP?**

Vitet e fundit, Arsimit Profesional i është dhënë prioritet dhe kjo ka qenë arsyeja që shkollat tona kaluan në vartësi direkte të ministrisë përgjegjëse për punësim, pasi lidhja dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset dhe Zyrat e Punës, do të garantonin aftësimin profesional të nxënësve në shkollë dhe direkt në vendin e punës. Siç përmenda edhe më lart, në fillimet tona, numri i nxënësve që studionin në AFP ishte relativisht i limituar. Diplomimet e para por edhe punësimi i nxënësve direkt në tregun e punës, po jepnin një imazh pozitiv, por ende kishim një numër të kufizuar vajzash. Për të balancuar numrin mes djemve dhe vajzave, duhej punuar

shumë me nxënësit e shkollave 8-vjeçare dhe veçanërisht me prindërit e tyre. Për këtë arsye, ne vendosëm që krahas punës bindëse dhe promovimit të shkollës, të pranonim vajza pa marrë në konsideratë kriterin e notës mesatare, duke përfshirë edhe vajza të komuniteteve romë dhe egjiptiane.

**Vetëm pak muaj më parë “Shkolla Hoteleri-Turizëm” u pagëzua si qendër ekselence nga ETF - European Training Foundation dhe tashmë është pjesë e rrjetit dhe familjes së madhe të ekselencës. A mund të na tregoni diçka më tepër rreth këtij rrugëtimi?**

Në vitin 2019, ETF (European Training Foundation), kërkoi nga institucionet qëndrore për Arsim Profesional, shkollat e nominuara për të qenë pjesë e një rrjeti shkollash ekselence (ETF Network for Excellence/ENE), me fokus “të nxënësit në vendin e punës”. Më vonë ETF përzgjodhi pikërisht shkollën tonë. Qëllimi, është bashkëpunimi mes shkollave të këtij rrjeti duke shpërndarë eksperiencat, përmirësimi cilësor i praktikave aktuale që zhvillon institucioni, krijimi i partneriteteve mes shkollave të rrjetit e më gjerë, trajnime me drejtuesit dhe koordinatorët e marrëdhënieve të shkollës me biznesin dhe mundësitë e financimit për nxënësit praktikantë dhe mësuesit monitorues të praktikave profesionale në biznes. Ndër iniciativat e këtij rrjeti është “Roli i shkollave profesionale të Ekselencës, për të mësuarit në vendin e punës”.

**Çfarë do të thotë të jesh pjesë e këtij rrjeti dhe a mund të na thoni diçka më tepër rreth projekteve të ardhshme më të cilat po punoni, kryesisht rreth atyre që kanë në fokus inovacionin?**

Qenia pjesë e një rrjeti shkollash ekselence, në rradhë të parë është përgjegjësi dhe sigurisht kërkon akoma edhe më shumë punë dhe përkushtim. Nga ana tjetër, është një vlerësim dhe kënaqësi për punën e madhe që bëhet në shkollën tonë dhe sidomos në bashkëpunim me bizneset partnere, të cilat dy vite më parë arritën në 266 partneritete. Përsa i përket projekteve të tjera, aktualisht shkolla është pjesë e një projekti të OEAD (Kultur-Kontakt), Austria ku në fokus është bashkëpunimi me konviktin e shkollës (koncepti i hotelit mësimor), jo vetëm për të realizuar praktikat profesionale të nxënësve në konvikt, por edhe përmirësimi i cilësisë së ushqimit dhe shërbimit për nxënësit konviktorë. Nga ana tjetër mësuesit tanë në bashkëpunim me kolegët austriakë, kanë trajnuar mësuesit e shkollave të tjera profesionale për aftësimin me kompetencave profesionale të nxënësve të tyre, bazuar në skeletkurrikulat kombëtare. Kohët e fundit është realizuar me sukses edhe përgatitja e materialeve mësimore për drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm”.





**Si mund t'i inkurajojmë të rinjtë në përgjithësi dhe vajzat e reja në vecanti që të mos i "druhen" studimit në shkollat e arsimit profesional? A mund t'u tregoni atyre shkurtimisht raste suksesi dhe frymëzues nga nxënës/it e shkollës tuaj?**

Unë mendoj që tashmë të rinjtë dhe familjet e tyre kanë kuptuar që shkollimi profesional është shkollimi i duhur. Nxënësit e shkollës sonë, tashmë punësohen që gjatë viteve të shkollimit, dhe vazhdojnë të jenë pjesë e tregut të punës edhe nëse studiojnë në IAL. Sot mund të them me krenari se shumë nga nxënësit tanë kryejnë detyra drejtuese në shume hotele dhe restorante prestigjioze në Tiranë, por jo vetëm, gjithashtu në Gjermani, Angli, Irlandë, Maltë, Dubai

**Cili do të ishte mesazhi juaj për të gjithë lexuesit e buletinit, për të gjithë të rinjtë dhe të rejtat në Shqipëri?**

Shkolla duhet të mësojë njerëz që dinë të ushtrojnë profesione dhe Arsimit Profesional të krijoj shumë mundësi dhe shanse në jetë. Mesazhi i nxënësve tanë për të rinjtë që janë përpara zgjedhjeve të tyre për shkollim është: **"Ne e kemi bërë zgjedhjen tonë, tani është rradha juaj"**. Ky mesazh shkon nga nxënësit tanë, për të gjithë të rinjtë që duan të garantojnë të ardhmen e tyre, nëpërmjet aftësimit teoriko-praktik në shkollat e Arsimit Profesional.



## Coffee Talk 7, një takim ndryshe dedikuar vajzave dhe grave në AFP, ndërkohë që edhe industria po bëhet femërore!

Takimi ynë i përmuajshëm **Coffee Talk**, me aktorë të institucioneve e shkollave të arsimit profesional, prindër, nxënës e dashamirës së kauzës për një arsim profesional më cilësor, ku të gjithë mund të kontribuojmë, kësaj rradhe u zhvillua në një atmosferë tejet të veçantë. Në muajin mars, në Muajin e Historisë së Grave, u trajtua tematika e rrugëtimit të vajzave dhe grave në Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri; me të gjitha uljet dhe ngritjet, sfidat dhe arritjet që kanë shënjuar këtë rrugëtim. Nën moderimin e Kostanca Dokut, mësimdhënëse në **Shkollën Profesionale TIK në Korçë**, mësues dhe nxënës ndanë përvojat dhe historitë e tyre, duke diskutuar më gjerësisht rreth arritjeve dhe pengesave që kanë hasur ndikuar nga mendësia e përgjithshme dhe stereotipet e ndryshme gjinore që ekzistojnë në përzgjedhjen e profesioneve të caktuara. Një diskutim ku u gërshetuan eksperiencat midis brezave, nga situata e vajzave në Arsimin dhe Formimin Profesional në sistemin politik të regjimit të kaluar e deri tek përvojat dhe gjendja aktuale në ditët e sotme.

Moderatorja Kostanca Doku, por edhe vetë drejtoresha e kësaj shkolle Julita Bimbli si dhe anëtarë të tjerë të stafit mësimor ndanë me pjesëmarrësit disa aktivitete, praktika dhe strategji të suksesshme që ka ndjekur shkolla e tyre për angazhimin dhe nxitjen e vajzave drejt aftësive profesionale. Ky CoffeeTalk përcolli edhe njëherë mesazhin se kur bashkohemi të gjithë bashkë mundemi të kontribuojmë në ecjen përpara dhe progresin e AFP-së në Shqipëri! Për t'ju bashkuar edhe ju këtij misioni ju ftojme të na ndiqni në rrjetet tona sociale dhe të bëheni pjesë e takimeve tona mujore!



## Arsimi dhe Formimi Profesional nga këndvështrimi i i studentëve të AFP-së

### Erika Mersinaj

*Disa fjalë nga Erika Mersinaj, nxënëse në Shkollën e Mesme Profesionale TIK, Korçë.*

Quhem Erika dhe studioj në Shkollën Teknologji Informimi dhe Komunikimi në qytetin e Korçës. Janë mbushur thujtë 4 vite që kur mora vendimin për të studiuar në një shkollë të arsimit profesional, dhe e them me plot bindje se ishte një dëshirë e imja për të cilën nuk jam penduar aspak. Ndër arsytet se përse kam zgjedhur të studioj në këtë shkollë është fakti se mund të marrësh një profesion që në një moshë të hershme, njohuri bazë, aftësi të specializuara, mundësi të shkëlqyera karriere, por mbi të gjitha të jep mundësinë të lidhesh më shpejt me tregun e punës. Shkolla ku unë studioj na i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe mjetet e punës. Ndërkohë, i kushtohet një përparësi e veçantë zhvillimit të praktikave në laboratorët e shkollës, të cilët janë gjithashtu të kompletuar. E, njëkohësisht, na ofrohet edhe mundësia e realizimit të praktikave nëpër biznese.

Ndihem shumë e kënaqur dhe e plotësuar nga njohuritë që kam marrë përmes këtij arsimit dhe aspiroj të vijoj studimet edhe më tej. Me një fjalë do ta përshkruaja degën që kam përzgjedhur të studioj me shumë pasion, si një fushë studimi që integron shkencën e elektronikës, telekomunikacionit, informatikës dhe medias. Ndërmjet këtij përshkrimi të shkurtër për arsimin profesional dua t'i përcjell një mesazh të gjithë të rinjve, e në veçanti të gjitha vajzave që mund të jenë skeptike për t'u orientuar drejt aftësive profesionale. **Nëse synoni të jeni vajza të suksesshme dhe të arrira në karrierën tuaj profesionale në të ardhmen, zgjidhni arsimin profesional sot sepse aty do të gjeni pafund mundësi.**







## INTERVET WB PROJECT IN A SNAPSHOT!

### Giulia Quaglietti

Koordinatorë për Shqipërinë dhe Kosovën pranë **Uniser**, organizata drejtuese e INTERVET e cila ofron shërbime mobilitetesh mësimore që nga viti 1998.

**Përfitimet e INTERVET WB për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e AFP-së. Përse nuk duhet ta humbisni këtë mundësi të shkëlqyer?**

**INTERVET WB** është një mundësi e shkëlqyer për të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e Arsimit dhe Formimit Profesional në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i këtij projekti është i thjeshtë dhe tejet efektiv: të prezantojë kulturën e mobiliteteve të të mësuarit në sistemet e AFP-së në Ballkanin Perëndimor për të përmirësuar situatën e punësueshmërisë së studentëve. **Si synojmë ta realizojmë ne këtë?** Çelësi është zbatimi i skemave të lëvizshmërisë në BP me qëllim përmirësimin e kompetencave kryesore të pjesëmarrësve dhe të vetë organizatave të AFP-së, brenda rrjeteve të reja të palëve të interesuara që do të mbështesin rezultatet e projektit me kalimin e kohës. Si koordinator i projektit, Uniser beson fuqishëm se inovacioni në sistemin e AFP-së është fjala kyce dhe protagonistja absolute e INTERVET-it. Shkollat verore, Jobs Shadowing, Takimet Transnacionale, Trajnimit dhe Thematic Teams, janë të gjitha mjetet e ekspertizës, në të cilat do të përqendrohet implementimi i mënyrave të reja për të sjellë ndërkombëtarizimin brenda Sistemit të AFP-së në BP. Shkollat që do të marrin pjesë në aktivitetet e projektit do të kenë akses në një proces solid të pjesëmarrjes, miratimi dhe njohjes së lëvizshmërisë, i cili në fakt përqendrohet në një faktor kyç:

**Mundësi aksesueshmërie për të gjithë aktorët e përfshirë!**

### Një përmbledhje rreth aktiviteteve të 2020

Siç e dimë të gjithë, viti 2020 ishte një vit tejet i vështirë për shkak të pandemisë Covid 19. Edhe pse kjo situatë krijoi një seri sfidash për lëvizjen në përgjithësi, falë mbështetjes së të gjithë partnerëve të përfshirë, projekti

ynë ishte në gjendje të vazhdonte pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara me rezultate të suksesshme. Pjesëmarrja në këto aktivitete ishte e jashtëzakonshme, për të sjellë disa shembuj, takimi Thematic Team mbledhi më shumë se 130 punonjës të AFP-së në të gjithë Evropën për të diskutuar mbi tematikën e mobiliteteve në AFP, veçanërisht për mësuesit dhe stafin e shkollës; Detyrat e Trajnimit u zhvilluan në internet dhe u mbajtën nga Drejtuesit dhe Koordinatorët e Projektit të Uniser me organizatat pritëse dhe dërguese të Intervet EB, me një seri takimesh kushtuar menaxhimit, organizimit dhe menaxhimit të të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Projekt. Për ta përmbyllur, me shkollën e parë verore, e cila mbledhi gjithashtu shumë mësues dhe anëtarë të stafit të shkollës nga shkollat e Ballkanit Perëndimor për të diskutuar temën e Ndërkombëtarizimit dhe lëvizshmërisë.

### Një përmbledhje e shkurtër e pjesëmarrësve nga Shqipëria në aktivitetet e vitit 2020

Shqipëria mori pjesë në të gjitha aktivitetet e mësipërme, në thirrjen për mobilitetet e studentëve për praktika afatshkurtra që do të zhvillohet në qershor 2020 dhe në thirrjen për mobilitetet e mësuesve, për Job Shadoëing dhe për Shkollën Verore. Falë këtyre thirrjeve, studentët do të kenë mundësinë të udhëtojnë nëpër Evropë për të pasur përvoja praktike me një gjatësi prej një deri në tre muaj që me siguri do të pasurojnë përvojat dhe aftësitë e tyre. Nga ana tjetër, mësuesit janë thelbësorë në procesin e ndërkombëtarizimit dhe ata do të përfshihen në aktivitete të ndryshme të mbajtura nga organizata të konsoliduara sistemeve evropiane të AFP-së me një përvojë të gjatë e të suksesshme. Sapo të përfundojnë këto aktivitete, mësuesit dhe anëtarët e stafit të shkollës do të kenë mundësinë të sjellin përvojën e tyre në shkollat e tyre në Shqipëri në mënyrë që të përmirësojnë sektorin e AFP-së dhe të pasurojnë programet akademike me mobilitete.

### Aktivitetet e radhës që na presin në vijim

Në prill do të hapet thirrja e dytë me destinacion Poloninë për mobilitetet e studentëve, thirrja e dytë gjithashtu për Job Shadoëing dhe për Shkollën Verore që do t'u kushtohet mësuesve dhe stafit të shkollës. Intervet EB, falë punës së jashtëzakonshme të të gjithë partnerëve të përfshirë dhe entuziazmit të pjesëmarrësve po krijon mundësi të shumta. Mobilitetet e të mësuarit janë përvoja që ndryshojnë tërësisht jetën, të cilën mendoj se të gjithë duhet ta provojnë të paktën një herë, nuk ka rëndësi nëse jeni student apo mësues. Këto lloj përvojash lejojnë përmirësimin e aftësive personale e profesionale dhe aftësive ndërkulturore, duke krijuar një urë midis të rinjve, sistemeve arsimore dhe tregut të punës. **Është gjithmonë e rëndësishme të provojmë dhe përpiqemi të dalim nga zona jonë e komfortit në një botë që na pret krahëhapur me plot mundësi të reja!**





14  
project partners

6  
regional partners

8  
EU member states

## TË NJOHIM PARTNERËT TANË TË INTERVET WB

Në këtë projekt janë të përfshirë gjashtë partnerë rajonalë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia, si dhe 8 partnerë nga shtetet anëtare të BE-së: Italia, Belgjika, Holanda, Franca, Malta, Spanja, Sllovenia dhe Polonia. Në këtë rubrikë të buletinit të sotëm do të udhëtojmë drejt Kosovës dhe do të njihemi nga afër me Prishtina Rea-n.

56  
PRO-type mobilities

360  
Mobilities

54  
Job shadowing experiences

36  
teachers in summer schools



Ahmet Jetullahu-Meti

## DEVELOPMENT INNOVATION LEAD



### Prishtina Rea

**Prishtina REA**, me një përvojë të gjatë 20-vjeçare në ofrimin e shërbimeve profesionale në rajon, shfrytëzon përvojën dhe ekspertizën unike të zhvillimit të NVM-ve përmes shërbimeve të asistencës teknike në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit, në transferimin e njohurive nga partnerët ndërkombëtarë.

### Mbi 300 projekte të implementuara në 20 vite :

Prishtina REA është themeluar që nga viti 2001 për të siguruar në mënyrë profesionale dhe me kosto efektive mbështetje teknike, shërbime këshilluese dhe shërbime trajnuese për bizneset, të rinjtë, në Edukim-AFP, Punësim-Startups, NVM dhe sipërmarrësit, institucionet qeveritare të nivelit lokal dhe qendror në Kosovë dhe si promovues i zhvillimit ekonomik lokal.

Prishtina REA është e fokusuar në hartimin dhe zbatimin e strategjive të konkurrencës dhe inovacionit, duke asistuar dhe mbështetur klientët rreth një sërë çështjesh që lidhen kryesisht me zhvillimin, inovacionin dhe konkurrencën për të siguruar zhvillim të qëndrueshme dhe rritje të cilësisë së jetës të brezave aktualë dhe gjeneratave të së ardhmes. "Vula jonë e Cilësisë" është përvoja jonë shumëvjeçare në angazhimin e një game të gjerë ekspertësh të fushave përkatëse, duke u bazuar në trendet më aktuale të zhvillimit të Sipërmarrjes, NVM-e dhe punëdhënësve që hasin vështirësi në betejën e tyre në përshtatjen me rrethanat e tregjeve globale dhe zhvillimin ekonomik. Prishtina REA implementon projekte që synojnë Transformimin Dixhital të NVM-ve, sektorit ICT dhe sektorin dixhital, inovacionin dhe ndërkombëtarizimin. Prishtina REA koordinon projektin **'Enterprise Europe Network Kosova'** dhe është partnerja implementues e BE-së në projektin **"Support for the Competitiveness of Kosovo's ICT Sector"**, duke punuar me më shumë se 900 biznese në Kosovë për ndërkombëtarizimin e tyre në rrjetin EEN. Prishtina REA është gjithashtu partnere në projektin 3-vjeçar **'VET Internationalisation System in WB'**, që synon kryerjen e rreth 620 mobiliteteve të formave të ndryshme në vendet e BE-së.



## Celebrate International Girls in ICT Day with AlbanianSkills!

Në shumë vende të botës, gratë dhe vajzat vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në fushat e Matematikës, Inxhinierisë, Teknologjisë dhe Shkencës (STEM). Të jetuarit në epokën dixhitale e ka shndërruar barazinë gjinore në një nga përparësitë globale. 22 Prilli shënon Ditën Ndërkombëtare të Vajzave në ICT dhe AlbanianSkills do të bashkohet në festimet dhe aktivitetet mbarëbotërore të kësaj dite. Le ta festojmë këtë ditë me histori frymëzuese të vajzave në sektorin TIK, të shkëmbejmë përvoja dhe të lidhemi së bashku. Bashkohuni me ne në këtë ditë!

Na ndiqni në rrjetet tona sociale - AlbanianSkills



E ENJTE, 22 PRILL